



Doracak

për publikimin e akteve
dhe politikave publike në nivel komunal



HELVETAS
Swiss Intercooperation

KOSOVO



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Doracak për publikimin
e akteve dhe politikave publike
në nivel komunal

Mars, 2016

Tabela e përmbajtjes

| | |
|--|----|
| Qëllimi i Doracakut | 5 |
| 1. Hyrje | 5 |
| 1.1 Korniza ligjore për transparencë në Komuna..... | 5 |
| 2. Ligji për vetëqeverisje Lokale | 6 |
| 3. Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna..... | 7 |
| 4. Udhëzimi Administrativ për ueb faqet e institucioneve publike | 8 |
| 5. Publikimi i akteve të aprovuara nga Kuvendi i Komunës | 9 |
| 6. Roli i organeve në transparencën e akteve të Kuvendit të Komunës..... | 10 |
| 7. Publikimi i akteve të miratuara nga Kryetari i Komunës | 11 |
| 8. Roli i organeve në transparencën e publikimeve të akteve | 12 |
| 9. Transparenca e komunës në konsultimin e publikut para miratimit të akteve | 13 |
| 10. Roli i organeve në transparencën e konsultimeve për projekt aktet e organeve komunale..... | 14 |
| 11. Transparenca e komunës rreth shpenzimeve financiare..... | 15 |
| 12. Roli i organeve në transparencën e financave lokale | 15 |
| 13. Transparenca e Komunës rreth hartimit të buxhetit komunal..... | 16 |
| 14. Roli i organeve rreth publikimit të Kornizës Buxhetore Komunale (KAB)..... | 17 |
| 15. Transparenca në hartimin dhe publikimin e buxhetit komunal | 17 |
| 16. Roli i organeve rreth publikimit të buxhetit komunal | 18 |
| 17. Transparenca e komunës në planifikimin hapësinor..... | 19 |
| 18. Roli i organeve në transparencën e planifikimit hapësinor..... | 20 |
| 19. Mbikëqyrja e akteve të organeve komunale nga niveli qendror | 21 |

Qëllimi i Doracakut

Ky doracak është hartuar për t'i ndihmuar zyrtarët komunalë në respektimin e legjislacionit për transparencë dhe përfshirjen e publikut në proceset vendimmarrëse me theks të veçantë në publikimin e akteve të organeve komunale dhe politikave publike në nivel lokal.

Doracaku në mënyrë figurative dhe hollësisht këshillon zyrtarët përgjegjës në nivel lokal për mënyrën e publikimit të akteve dhe politikave publike si dhe përfshirjen e qytetarëve gjatë hartimit të akteve dhe politikave publike në nivel lokal. Ky doracak është hartuar pas shumë konsultimeve me akterë të ndryshëm që kanë për obligim ligjor publikimin e akteve dhe politikave publike në nivel lokal.

1. Hyrje

1.1 Korniza ligjore për transparencë në Komuna

Kushtetuta e Republikës së Kosovës si akt më i lartë juridik, i ka dhënë dimension të veçante transparencës së institucioneve në tërësi dhe mbi gjitha institucioneve në nivel lokal. Neni 40 dhe 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton të drejtën e lirisë së shprehjes, për të shpërndarë dhe marrë informacione, mendime e mesazhe pa u penguar nga askush si dhe të drejtën për qasje në dokumente publike¹.

Në aktin më të lartë juridik të vendit i është kushtuar një kapitull i tërë qeverisjes lokale, ku vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre².

¹ Neni 40 dhe 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, <http://gzk.rks-gov.net/ActsByCategory/Inst.aspx?Index=1&InstID=1&CatID=1>

² Po aty Neni 123 pika 4

Në pajtim me Kushtetutën, institucionet e Kosovës kanë vijuar në nxjerrjen e akteve tjera juridike (ligjore dhe nënligjore) ku në mënyrë më të detajuar përcaktohen të drejtat e qytetarëve për të qenë pjesë e vendimmarrjes në nivel lokal dhe obligimet e komunave për të qenë transparente në raport me publikun e gjerë.

Ligji për vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligji për qasje në dokumente publike Nr. 03/L-215, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 për transparencë në komuna, Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike, Rregulloret për transparencë në nivel komunal, Statutet e komunave dhe ligjet tjera sektoriale janë baza ligjore që obligojnë komunat për të qenë transparente në vendimmarrje si dhe në përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Ky doracak pasqyron obligimet dhe procedurat ligjore që duhet ndjekur institucionet lokale në publikimin e vendimeve dhe politikave lokale për të qenë transparente si dhe me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në hartimin e akteve dhe politikave publike në nivel lokal.

2. Ligji për vetëqeverisje Lokale

Ligji për vetëqeverisje Lokale është bazë për funksionimin dhe organizimin e pushtetit lokal. Ky ligj parasheh obligime për institucionet e nivelit lokal për të qenë transparent dhe për të nxitë pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Sipas ligjit për vetëqeverisje lokale kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale mund të nxjerrë udhëzime administrative për transparencë komunale³.

Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal nga koha e nxjerrjes së Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka nxjerrë udhëzime administrative për transparencë në komunë, mirëpo në asnjë nga këto

³ Neni 68.4 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/efd1b00c-21b5-4070-987c-58f2fe814155/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.aspx>

udhëzime të nxjerra nuk ka specifikuar në mënyrë të detajuar publikimin e vendimeve të Kryetarit të Komunës duke lënë mundësinë e interpretimeve të ndryshme sa i përket transparencës së punës së Kryetarit të Komunës.

Kësisoj, edhe Kuvendet e Komunave gjatë hartimit dhe miratimit të Rregullores për Transparencë kanë vazhduar me praktikën e njëjtë duke mos specifikuar obligimet e Kryetarit të Komunës në publikimin e akteve të tij.

Megjithatë, me Udhëzimin Administrativ 01/2015 për transparencë në komuna, i cili ka hyrë në fuqi që nga janari i vitit 2016, e ka rregulluar një vakum të deritanishëm për publikimin e akteve të Kryetarit të Komunës. Ky rregullim ligjor paraqet një avancim të dukshëm në obligimet e organeve të komunave në lidhje me publikimin e akteve në ueb faqe zyrtare të komunës

3. Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna

Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL) në vazhden e rregullimit të transparencës së institucioneve lokale ka hartuar dhe miratuar Udhëzimin e ri Administrativ Nr. 01/2015 për transparencë në komuna dhe i cili është në fuqi që nga janari i vitit 2016. UA është më i avancuar dhe kompletuar si bazë ligjore në raport me Udhëzimet Administrative të më hershme për transparencë në komuna.

Me këtë udhëzim administrativ obligohen organet e komunës që ndaj qytetarëve dhe ndaj palëve të interesuara të bëjnë transparente dhe të qasshme aktivitetet e komunës⁴. Publikimi i akteve, kërkesat për informim, iniciativa qytetare dhe peticion, takimet me publikun, takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarë, konsultimi i publikut para miratimit të akteve, qasja në dokumente publike, raportimi tek autoritetet mbikëqyrëse, planin e veprimit për transparencë në komuna si dhe funksionimi i ueb faqeve zyrtare të komunave janë pika kyç që përfshihen në udhëzimin administrativ për transparencë në komuna.

⁴ Neni 2 i Udhëzimit Administrative 01/2015 për transparencë në komunë, [https://mapl.rks-gov.net/getattachment/8d6c7e9b-fb76-452c-a618-717e61e78038/Udhëzim-administrativ-\(MAPL\)-Nr--01-2015-per-trans.aspx](https://mapl.rks-gov.net/getattachment/8d6c7e9b-fb76-452c-a618-717e61e78038/Udhëzim-administrativ-(MAPL)-Nr--01-2015-per-trans.aspx)

4. Udhëzimi Administrativ për ueb faqet e institucioneve publike

Qasja e drejtpërdrejtë në informata publike në formë elektronike është e garantuar me legjislacionin sekondar përkatësisht me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike. Çdo institucion publik duhet të ketë ueb faqen zyrtare. Përmbajtja e saj duhet të jetë informuese dhe e përditësuar, e shkruar saktë, që i përgjigjet kërkesave të audiencës dhe është e lehtë për tu qasur⁵.

Pra, edhe ky udhëzim administrativ në mënyrë direkte ka promovuar transparencën e institucioneve publike rreth publikimit të të dhënave bazike me interes për qytetarët. Udhëzimi Administrativ ka specifikuar se çka duhet të përmbajë ueb faqja e institucioneve publike.

Ndër të tjera, ueb faqja e institucioneve publike (komunave) duhet të përfshijë:

- Stemën e Republikës së Kosovës dhe emërtimin zyrtar të institucionit,
- Adresën e plotë të institucionit, numrin e telefonit dhe adresën e email-it për kontakt,
- Planin e punës për vitin kalendarik,
- Projekt aktet normative për konsultim publik,
- Të dhënat e përditësuara për veprimtarinë publike të institucionit (komunës),
- Strategjitë dhe dokumentet të tjera të politikave të miratuara,
- Të dhënat për biografitë e udhëheqësve të lartë të institucionit publik,
- Raportet vjetore të institucionit,
- Buxhetin e miratuar vjetor, të dhënat e shpenzimeve,
- Planin vjetor të prokurimit etj.

⁵ Neni 4 I UA 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike, [https://map.rks-gov.net/getattachment/5409918d-193e-4372-88b6-3ba29358bc89/Udhezimi-Administrativ-\(MAP\)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx](https://map.rks-gov.net/getattachment/5409918d-193e-4372-88b6-3ba29358bc89/Udhezimi-Administrativ-(MAP)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx)


Njësia përgjegjëse për komunikim e institucionit (ZIP) apo zyrtari i ngarkuar për komunikim me publikun është përgjegjës për redaktim dhe përditësimin e rregullt të të dhënave në ueb faqen e institucionit përkatës. Të gjithë njësitet organizative (drejtoritë komunale) obligohen që të bashkëpunojnë ngushtë me njësinë përgjegjëse për komunikim të institucionit publik (ZIP) apo zyrtarin e ngarkuar me këtë detyrë që të azhurnojë rregullisht ueb faqen e institucionit.

5. Publikimi i akteve të aprovuara nga Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës dhe Zyra për Informim kanë OBLIGIM të plotë në transparencën e vendimeve të Kuvendit të Komunës. Ky obligim rrjedh nga ligji për vetëqeverisje lokale dhe udhëzimi për transparencë në komuna.

Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL) përmes: shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës, medieve të shkruara dhe elektronike lokale dhe ueb faqen zyrtare të Komunës dhe rrjeteve sociale.

6. Roli i organeve në transparencën e akteve të Kuvendit të Komunës




7. Publikimi i akteve të miratuara nga Kryetari i Komunës

Udhëzimet Administrative të më hershme për transparencë në komuna, nuk e precizonin publikimin e akteve të Kryetarit të Komunës. Mos precizimi ishte një hendek tejet i madh në transparencën dhe publikimin e akteve nga ekzekutivi i komunës. Me ndryshimin dhe hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015 për transparencë në komuna është paraparë në mënyrë decidive edhe publikimi i akteve të Kryetarit të Komunës.

Kësisoj, të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës që ndikojnë drejtpërdrejt në interes të qytetarëve duhet të jenë publike në ueb faqen zyrtare të Komunës. Pas hyrjes në fuqi të akteve të Kryetarit të Komunës, zyrtari përgjegjës i informimit duhet t'i dërgojë për publikim në ueb faqen e komunës si dhe në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL).

8. Roli i organeve në transparencën e publikimeve të akteve



9. Transparenca e komunës në konsultimin e publikut para miratimit të akteve

Udhëzimi administrativ për transparencë në komuna, pos në transparencën rreth publikimit të akteve të miratuara, një mundësie të veçante i ka dhënë edhe transparencës dhe përfshirjes së publikut në vendimmarrjen komunale.

Kësisoj, aktet e organeve të komunës (Ekzekutivi dhe Kuvendi i Komunës) të cilat janë në interes për qytetarët i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit duke përfshirë edhe organizimin e debateve në vendet rurale.

Rol të rëndësishëm në procesin e konsultimit të vendimeve të kuvendit ka organi propozues që përgatit projekt aktin dhe është i obliguar të caktoj mënyrën e zhvillimit të konsultimit, afatin e konsultimit me qëllim të përfshirjes së grupeve të interesit, OJQ dhe qytetarët në proces.

Rol tjetër të rëndësishëm në procesin e konsultimit përveç propozuesit të aktit, rreth transparencës në vendimmarrjen komunale ka edhe Zyrtari për Informim, i cili e ka për detyrë që të informojë publikun **2 javë**⁶ para seancës së konsultimit publik si në format tradicionale (shpalljet publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës), ashtu edhe përmes medieve elektronike dhe të shkruara lokale, ueb faqen e komunës si dhe rrjeteve sociale.


Nga vetë fakti i përfshirjes së organit propozues në procesin e transparencës së vendimmarrjes komunale, ai duhet të marrë pjesë aktivisht në konsultim duke shpjeguar përmbajtjen e aktit para publikut dhe evidenton propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve. Propozimet e dhëna nga konsultimet publike, organi propozues i aktit i shqyrton brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimit.

Mbi gjitha, në konsultimet publike për aktet duhet të jetë i përfshirë domosdo edhe Kuvendi i Komunës. Kësisoj, organi propozues i aktit ka për obligim të informojë Kuvendin e Komunës për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara dhe ato të marra parasysh.

Në fund të procesit të konsultimeve të akteve të kuvendit të komunës, kuvendi si institucion duhet të kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projekt aktit.

6 Neni 68 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale

10. Roli i organeve në transparencën e konsultimeve për projekt aktet e organeve komunale




11. Transparenca e komunës rreth shpenzimeve financiare

Kryetari i Komunës duhet të përgatit dhe t'i dorëzoj kuvendit të komunës raporte tre-mujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje duhet t'i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tre mujori dhe më pas duhet të publikohet nga kryetari i komunës në ueb faqen e internetit të komunës⁷.

Kryetari i Komunës duhet të përgatit dhe t'i dorëzoj Kuvendit të Komunës një raport përfundimtar përmbledhës buxhetor. Raporti përfundimtar përmbledhës duhet të dërgohet në Kuvendin e Komunës jo më vonë se 31 mars të çdo viti kalendarik i cili përmban të dhënat e buxhetit të vitit të kaluar fiskal dhe dy viteve paraprake⁸.

12. Roli i organeve në transparencën e financave lokale



7 Neni 40 paragrafi 1 i Ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit, <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8856>
8 Po aty neni 45 paragrafi 4


13. Transparenca e Komunës rreth hartimit të buxhetit komunal

Ministri i ekonomisë dhe financave është i autorizuar dhe përgjegjës që të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e buxhetit. Pra, në kuadër të ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë, Ministria e Ekonomisë çdo vit fiskal lëshon qarkore buxhetore që udhëzon organizatat buxhetore/komunat në përgatitjen e buxhetit komunal.

Qysh në fazën fillestare, komunat duhet të promovojnë transparencë të plotë në hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB). Zyrtaari Kryesor Financiar në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive komunale harton draftin e KAB, më pas Kryetari e prezanton në Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe e dorëzon në Kuvendin e Komunës për diskutim publik.

Konsultimet do të mbahen me komunitetin dhe palët kyçe, përfshirë edhe takimet publike për të diskutuar prioritetet dhe objektivat strategjike të komunës. Pas kësaj faze, Kuvendi i Komunës shqyrton dhe aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale e aprovuar publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës.

14. Roli i organeve rreth publikimit të Kornizës Buxhetore Komunale (KAB)




15. Transparenca në hartimin dhe publikimin e buxhetit komunal

Buxheti dhe planet e komunës janë dokumente publike. Komuna me shpenzimet e saj merr masa për ti vënë këto dokumente në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe palëve të interesuara në formë të plotë ose të shkurtuar sipas kërkesës së palëve të adresuar përmes zyrtarit/njesisë për informim me publikun⁹.

⁹ Neni 4 paragrafi 2 dhe 3 | Udhëzimit për Transparençë në Komuna, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/cbc5e4a1-44d9-4c37-9fa9-600786d26a42/Administrativno-Uputstvo,-05-2013-O-transparentnos.aspx>

16. Roli i organeve rreth publikimit të buxhetit komunal



17. Transparenca e komunës në planifikimin hapësinor


Një nga parimet bazë në planifikimin hapësinor mbetet promovimi transparencës në procesin e vendimmarrjes duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor¹⁰.

Shqyrtimet publike për projekt dokumentet e planifikimit hapësinor i organizon drejtoria komunale kompetente në suaza të kompetencave ligjore. Drejtoria komunale kompetente (Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor) është përgjegjëse në përfshirjen e publikut në hartimin, zbatimin dhe revidimin e projekteve: Planin Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale të Komunës, Planet Rregullative të Komunës.

10

Neni 4 paragrafi 1.3 i Ligjit për Planifikim Hapësinorë, <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2471>

18. Roli i organeve në transparencën e planifikimit hapësinor



19. Mbikëqyrja e akteve të organeve komunale nga niveli qendror

Vendimet e organeve komunale i nënshtrohen shqyrtimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikqyrës. Si autoritet mbikqyrës i shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të organeve komunale është Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL). Organet komunale dhe mbikëqyrëse obligohen për të bashkëpunuar më njëri tjetrin në procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve.

Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të marrë dhe sigurojë informata të plota për të gjitha çështjet, përfshirë të drejtën për t'i vizituar zyrat komunale dhe objektet komunale dhe të drejtën për të kërkuar qasje në dokumentet komunale. Kryetari i komunës është përgjegjës për t'ia vënë në dispozicion informacionet autoritetit mbikqyrës.

| Shqyrtimi i rregullt i akteve | Veprimi | Shqyrtimi i detyrueshëm i akteve | Veprimi |
|---|---|--|---|
| Autoriteti mbikqyrës ka të drejtë të mbikqyrë çdo akt i cili nuk është kontrolluar sipas procedurave të shqyrtimit të detyrueshëm, brenda 30 ditësh pas pranimit të listës deri më datë 10 të çdo muaji | Kryetari i komunës i dërgon autoritetit mbikqyrës listën e të gjitha akteve të miratuara nga kryetari dhe kuvendi në muajin paraprak, deri më datën 10 të çdo muaji | a) aktet e përgjithshme të miratuara nga kuvendet komunale; b) vendimet lidhur me aktivitetet e përbashkëta të partneriteteve për bashkëpunim; c) aktet e miratuara brenda kornizës së implementimit të kompetencave të deleguara. | 1. Të gjitha komunat obligohen që t'ia dorëzojnë aktet e përmendura autoritetit mbikqyrës brenda 7 ditësh nga dita e nxjerrjes së tyre. 2. Autoriteti mbikqyrës vërteton pranimin e aktit të qeverisë lokale përmes regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikqyrës. 3. Autoriteti mbikqyrës obligohet që të japë mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij. |

Referencat

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <http://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=1&InstID=1&CatID=1>
- Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje Lokale, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/efd1b00c-21b5-4070-987c-58f2fe814155/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.aspx>
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna, [https://mapl.rks-gov.net/getattachment/8d6c7e9b-fb76-452c-ab18-717e61e78038/Udhezim-administrativ-\(MAPL\)-Nr--01-2015-per-trans.aspx](https://mapl.rks-gov.net/getattachment/8d6c7e9b-fb76-452c-ab18-717e61e78038/Udhezim-administrativ-(MAPL)-Nr--01-2015-per-trans.aspx)
- Udhëzimi Administrativ 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike, [https://map.rks-gov.net/getattachment/5409918d-193e-4372-88b6-3ba29358bc89/Udhezimi-Administrativ-\(MAP\)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx](https://map.rks-gov.net/getattachment/5409918d-193e-4372-88b6-3ba29358bc89/Udhezimi-Administrativ-(MAP)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx)
- Ligji Nr. 05/L-007 për ndryshim plotësim të ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Nr. 05/L-063, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12387>
- Qarkoret buxhetore për komuna të nxjerra nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret-buxhetore>
- Ligji Nr. 04/L-147 për Planifikimin Hapësinorë, <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10226>
- Udhëzimi Administrativ 05/2014 për përgjegjësit e autoriteteve të planifikimit hapësinorë si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinorë, <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10226>

Doracaku është sponsorizuar nga Organizata HELVETAS Swiss Intercooperation Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave DEMOS që financohet nga Zyra e Qeverisë Zvicerane në Kosovë (SCO).

Doracak për publikimin e akteve
dhe politikave publike
në nivel komunal



Nazim Gafurri str. 33
PO Box no.2
10000 Pristina, Kosovo
www.helvetas-ks.org
<https://www.facebook.com/demosproject>

Tel: +381(0) 38 51 77 15
Tel: +381(0) 38 51 66 44
Fax: +381(0) 38 51 88 33
kosovo.info@helvetas.org